

KUSHTET DHE AFATET E PROMOCIONIT “Furrë & Pianurë inkaso + set WMF”

1. Samsung Electronics Austria GmbH, Austri, Vjenë, Praterstrasse 31/14 Obergeschoss (në vijim referuar si: Samsung), organizon promovionin për paketën furrë & pianurë inkaso, në të cilin Samsung mund t'i japë blerësve të furrave dhe pianurave inkaso Samsung bazuar në listën e modeleve të aplikueshme specifikuar në pikën 7 më poshtë, set enësh WMF “Diadem Plus” siç specifikohet në dispozitat vijuese të këtyre Kushteve dhe Afateve, të gjitha me plotësimin e prezumimeve dhe kushteve të përcaktuara në këto Kushte dhe Afate.

Të gjithë blerësit e një ose më tepër prej paketave furre & pianurë inkaso Samsung me një vlerë totale kumulative më të madhe se 62000 Lek, blerë në periudhën nga 29.11.2019. deri më 31.12.2019., ose deri sa të përfundojë stoku, do të kenë të drejtë të marrin një dhuratë sipas përcaktimeve të këtyre Kushteve dhe Afateve.

Dhurata që blerësit do të kenë të drejtë të përfitojnë është si vijon:
Për blerjen e paketës furrë & pianurë inkaso Samsung, dhurata është:
Set enësh WMF “Diadem Plus”

Në pikën 7 të këtyre Kushteve dhe Afateve ndodhet një listë modelesh ose kodesh modelesh të furrave dhe pianurave inkaso Samsung të cilat janë subjekt të këtij promovioni.

Numri i dhuratave është i limituar dhe do t'i dorëzohet blerësve të cilët regjistrohen përpara se stoku të mbarojë.

2. QËLLIMI DHE KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË PAJISJEVE

Konsumatori fundor i cili ka blerë një furrë dhe pianurë inkaso Samsung siç përcaktohet në pikën 1 të këtyre Kushteve dhe Afateve ekskluzivisht brenda periudhës së specifikuar në pikën 1 të këtyre Kushteve dhe Afateve, do të regjistrohet me qëllim pjesëmarrjen në këtë promovion nëpërmjet dërgimit të një e-mail në adresën ce.promo@samsung.com. Regjistrimi do të mund të kryhet brenda një periudhe 30 ditore nga data e blerjes.

Në rast të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtyre Kushteve dhe Afateve dhe të regjistrimit me sukses, blerësit do të kenë të drejtën të përfitojnë dhuratën specifikuar në pikën 1 të këtyre Kushteve dhe Afateve deri sa stoku i dhuratave të përfundojë. Dhurata do u dorëzohet konsumatorëve të fundit në adresë pa shpenzime transporti, brenda 45 ditëve pas regjistrimit me sukses.

3. KUSHTET PËR REGJISTRIMIN

Të gjithë blerësit në territorin e Republikës së Shqipërisë të cilët blejnë furrë dhe pianurë inkaso Samsung me kod modeli të specifikuar në pikën 7 të këtyre Kushteve dhe Afateve, kanë të drejtë të regjistrohen dhe marrin pjesë në këtë promovion sipas kushteve të parashikuara në këto Kushte dhe Afate, dhe vetëm nëse produkti blihet nga një nga partnerët e mëposhtëm të Samsung:

Neptun

Globe

GoTech

4. PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË PAJISJEVE

Me qëllim që blerësi i furrës dhe pianurës inkaso Samsung të ketë mundësi të marrë pjesë në këtë Promocion dhe të ushtrijë të drejtën për të përfituar dhuratën e përcaktuar në pikën 1 të këtyre Kushteve dhe Afateve, blerësi duhet të regjistrohet në përputhje me dispozitat e tjera të këtyre Kushteve dhe Afateve.

Procedura e regjistrimit konsiston në vënien në dispozicion të të dhënave personale të blerësit të nevojshme për një regjistrim të suksesshëm. Të dhënat personale të blerësit që do të mblidhen janë: emri, mbiemri, adresa e e-mail e blerësit, adresa e banimit e blerësit (për dorëzimin e dhuratës)*, numri i telefonit (me qëllim kontaktimin lidhur me dorëzimin e dhuratës) dhe një paraqitje (skanim) i faturës për blerjen e pajisjeve.

Përveç të dhënave personale të mësipërme, për regjistrim të suksesshëm, blerësi duhet t'i dërgojë Samsung informacionin e mëposhtëm:

- modeli dhe numri serial i të dy pajisjeve

Duke dërguar një e-mail në adresën e përcaktuar në pikën 2 të këtyre Kushteve dhe Afateve, blerësi i dërgon Samsung të dhënat e tij ose të saj. Samsung do të kontrollojë nëse data e blerjes korrespondon me kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtyre Kushteve dhe Afateve dhe nëse janë plotësuar kushtet e tjera të parashikuara në këto Kushte dhe Afate. Me dërgimin e këtij e-mail, blerësi jep shprehimisht pëlqimin e tij ose të saj për zbatimin e këtyre Kushteve dhe Afateve dhe për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të tij personale në përputhje me kushtet e këtyre Kushteve dhe Afateve.

Nëse data e blerjes korrespondon me këto Kushte dhe Afate dhe nëse kushtet e tjera të parashikuara në këto Kushte dhe Afate plotësohen, dhurata e përcaktuar në pikën 1 të këtyre Kushteve dhe Afateve do t'i dorëzohet blerësit në adresën e tij të banimit brenda 45 ditëve nga momenti i regjistrimit me sukses, regjistrim për të cilin blerësi do të informohet me një e-mail dërguar në adresën e e-mailit të dhënë gjatë regjistrimit.

**Adresa juaj e plotë duhet të përmbajë:*

Emrin e rrugës

Numrin e ndërtesës

Numrin e hyrjes

Numrin e apartamentit

Numrin e njësisë administrative

Kodin Postar

Qytetin

Numrin e telefonit

5. PËRDORIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të blerësve që dërgojnë të dhënat e tyre për Samsung në përputhje me këto Kushte dhe Afate do të mblidhen dhe përpunohen në përputhje me Politikën e Privacisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Samsung, këto Kushte dhe Afate, si dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënave personale është për të kontrolluar nëse janë përmbushur kushtet për pjesëmarrjen në promovimin në fjalë dhe për të përcaktuar adresën për dorëzimin e dhuratës.

Të dhënat personale të blerësve që do të mblidhen lidhur me promovimin në fjalë do të vihen në dispozicion personave juridik vijues:

- Samsung Electronics Austria GmbH, Austri, Vjenë, Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, në cilësinë e Kontrolluesit të mbledhjes së të dhënave personale, MPG d.o.o., Nova Ves 17, Zagreb, Kroaci në cilësinë e agentit dhe përpunuesit të të dhënave personale.

Kontrolluesi i të dhënave personale dhe përpunuesi i të dhënave personale do të trajtojnë të dhënat personale të mbledhura në përputhje me Politikën e Privacisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Samsung, si dhe me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë dhe nuk do ia shpërndajnë asnjë pale të pretë.

Mbledhja e të dhënave personale lidhur me këtë promovim është vullnetar. Nëse blerësi vendos mos të ndajë me Samsung të dhënat personale të tij ose saj, blerësi nuk do të ketë mundësi të marrë pjesë në këtë promovim.

Kontrolluesi i të dhënave personale, me kërkesë të pronarit të të dhënave personale, do të shtojë, modifikojë apo fshijë të dhënat personale nëse janë të paplota, të pasakta apo të pa përditësuara dhe nëse përpunimi nuk është në përputhje me ligjin.

6. E DREJTA PËR TË NDRYSHUAR KUSHTET DHE AFATET E PROMOCIONIT

Samsung rezervon të drejtën që, në çdo kohë, për shkaqe të arsyetuara, të ndryshojë këto Kushte dhe Afate duke u angazhuar që t'i bëjë të ditura pa vonesë. Nëse këto ndryshime përfshijnë ndryshimin e kushteve të përdorimit të të dhënave personale, Samsung do të kërkojë pëlqimin e klientëve të cilët i kanë dërguar Samsung të dhënat e tyre personale lidhur me këtë promovim.

7. LISTA E MODELEVE SUBJEKT TË PROMOCIONIT

Modelet	Kategori
BF1C4T043/BOL	BI OVEN
BF1C6G043/BOL	BI OVEN
BF3ON3T011/BOL	BI OVEN
BF641FGB/BOL	BI OVEN
BF641FST/BOL	BI OVEN
BRB260000WW/EF	BI REF
BRB260010WW/EF	BI REF
BRB260031WW/EF	BI REF
BRB260035WW/EF	BI REF
BRB260087WW/EF	BI REF
BRB260130WW/EF	BI REF
BRB260131WW/EF	BI REF
BRB260176WW/EF	BI REF

BRB260178WW/EF	BI REF
BRB260187WW/EF	BI REF
BRB260189WW/EF	BI REF
C21RJAN/BOL	BI CT
C61R2AAST/BOL	BI CT
C61R2CAST/BOL	BI CT
CTR164NC01/BOL	BI CT
CTR464EB01/XEO	BI CT
DW50R4040BB/EO	BI DW
DW60M5040BB/EO	BI DW
DW60M5060BB/EO	BI DW
DW60M6040BB/EO	BI DW
DW60M6040FW/EC	BI DW
DW60M6050BB/EO	BI DW
DW60M6050FS/EC	BI DW
DW60M6050SS/EO	BI DW
DW60M9550BB/EO	BI DW
FG87K-B/BOL	BI MWO
FG87KST/BOL	BI MWO
FG87SST/BOL	BI MWO
FG87SUB/BOL	BI MWO
FG87SUG/OL	BI MWO
FG88SUST/OL	BI MWO
HDC6145BX/BOL	BI Hood
HDC6255BG/BOL	BI Hood
NA64H3010AS/L1	BI CT
NA64H3041BS/L1	BI CT
NK24M1030IS/UR	BI Hood
NK24M3050PS/U1	BI Hood
NK24M3050PS/UR	BI Hood
NK24M5060SS/UR	BI Hood
NK24M5070BG/UR	BI Hood
NK24M5070CS/UR	BI Hood
NK24M7070VB/UR	BI Hood
NK24M7070VS/UR	BI Hood
NK24N9804VB/UR	BI Hood
NK36M7070VB/UR	BI Hood
NK36M7070VS/UR	BI Hood
NQ50H5537KB/EO	BI Compact
NQ50J5530BS/EO	BI Compact
NQ50K3530BG/EO	BI Compact
NV66F3523BS/OL	BI OVEN
NV66M3531BB/EO	BI OVEN
NV66M3531BS/OL	BI OVEN
NV68R2340RM/EG	BI OVEN

NV68R2340RM/OL	BI OVEN
NV68R2340RS/EO	BI OVEN
NV68R2340RS/OL	BI OVEN
NV70H3350RS/EO	BI OVEN
NV70K1340BB/OL	BI OVEN
NV70K1340BS/OL	BI OVEN
NV70K2340RB/OL	BI OVEN
NV70K2340RM/EG	BI OVEN
NV70K2340RS/EO	BI OVEN
NV70K3370BS/OL	BI OVEN
NV73J9770RS/EO	BI OVEN
NV75J3140BB/OL	BI OVEN
NV75J3140BS/OL	BI OVEN
NV75J3140RS/OL	BI OVEN
NV75J5170BS/EO	BI OVEN
NV75K5571RS/OL	BI OVEN
NV75N5641RB/EO	BI OVEN
NV75N5641RB/OL	BI OVEN
NV75N5671RS/OL	BI OVEN
NV75R5641RB/OL	BI OVEN
NZ64H57477K/EO	BI CT
NZ64H57479K/EO	BI CT
NZ64M3707AK/OL	BI CT
NZ64M3NM1BB/OL	BI CT
NZ64N7757GK/E2	BI CT
NZ64N9777BK/E2	BI CT
NZ84J9770EK/EO	BI CT